

Kapitulli - II

Rregullativa në profesionin e auditimit

Rregulloret e auditorëve

Për të ruajtur standardet më të larta në profesionin e auditimit, janë dizajnuar kërkesat për pranimin, regjistrimin dhe trajnimin e audituesve.

Strukura e profesionit të kontabilistit dhe audituarit është:

- E rregulluar në mënyrë strikte me legjislacion ose statut
- E vetë – rregulluar (prej organizmave profesional)

Kosova

- Rregullohet me Ligj.
- Organ mbikqyrës është KKRF
 - vendos SNRF dhe të auditimit (SNA),
 - mbikqyrë cilësinë e punës së auditorit,
 - aprovon/licencon firma auditimi
 - aprovon/licencon auditues ligjor
 - aprovon/licencon shoqata të kontabilitetit dhe auditimit
- ShKÇAK
 - e aprovuar nga KKRF
 - ofron programin për edukim profesional për auditues ligjor

Mbretëria e Bashkuar

Profesioni rregullohet nga organizma privat.

- Numër i madhë i shoqatave dhe institucioneve:
 - ACCA
 - CIMA
- Kërkesat e përbashkëta:
 - Kërkesa të forta për pranim(provimi-eksperienca)
 - Kode rigorozë të etikës
 - Përditim i njohurive teknike të anëtarëve

Franca

Profesioni rregullohet nga qeveria.

- Ndahet në dy organizata:
 1. Kontabilistët (Ordre des Experts Comptables et des Agrees)
 2. Audituesit (Compaigne Nationale des Commissaires aux Agrees)

Gjermania

- Instituti i kontabilistëve të certifikuar publik (IDV)
 - kryen auditime ligjore
 - publikon standarde të auditimit

Gana

- Instituti i kontabilistëve të autorizuar 1963
 - anëtarë persona të njohur sipas legjislacionit të kompanive
 - udhëhiqet prej këshillit me 11 anëtarë - kontabilista

SHBA

Profesioni rregullohet me efektivitet nga organizmat privat.

- AICPA anëtarë të gjithë kontabilistat e çertifikuar publik
- SEC nxjerrë standarde për kompanit e regjistruara/listuara në bursë duke u mbështetur në FASB
- FASB bashkëpunon ngusht me AICPA
- nxjerrë udhëzime mbi standardet Amerikane
- mirret me zhvillimin e tyre

Singapori

- ICPAS 1963

Bashkimi Evropian

- Auditorët sigurojnë leje prej autoriteteve përkatëse.
 - Në MB nga ONjM - organizmi i njohur mbikëqyrës
 - Mbikëqyr dhe monitoron audituesit
- Në vende të tjera monitorimi bëhet nga organizma të themeluar për mbikëqyrje apo qeverive kombëtare.

Në nivelin ndërkombëtarë :

- Vendosen standardet minimale dhe kërkesat për auditues
- Udhëzohen me korniza kombëtare të mirë-zhvilluara
- Siguron njohjen nga të gjitha vendet e botës të kualifikimeve profesionale për kontabilitet.


Rregulloret mbikëqyrja dhe monitorimi

Shumica janë të ndryshme nëpër vende, por kanë

Elementet e përbashkëta:

- a) Arsimimi dhe eksperiencia e punës
- b) Pranimi
- c) Mbikëqyrja dhe monitorimi
 - Nga vetë-rregullimi
 - Nga agjencit e jashtme qeveritare

Rregullativa e audituesit



Arsimimi, provimet dhe eksperienca

Për tu pranuar ndërkombëtarisht, IFAC – Deklarata e Njohjes e kualif.te kontabil.profesionist. Tri çështjet kryesore të kualifikimit janë:

Arsimimi

- Njohuritë e detyrueshme (Provimet)
- Njohuritë që duhet të përfshihen vetëm kur duhet (Ligjet)

Provimet (testohen kompetencat)

- Vlerësimi i nivelit të domosdoshëm të njohurive teorike
- Vlerësimi i aftësive për t'i zbatuar me kompetencë në praktik
- Kërkesë Kyçe – Vlerësimi objektiv i provimit profesional

Eksperienca

Para se të quhet “*I KUALIFIKUAR*” duhet të përmbushë:

- Tri vjet eksperiencë praktike të aprovuar dhe të mbikqyrur
- Në auditim, kontabilitet, mjedis profesional.

IFAC - FNK

- E themeluar në vitin 1970 me seli në Nju Jork (SHBA)
- Misioni:
 - zhvillimi dhe përmirësimi i profesionit që të mundësojë dhënjen e përhershme të shërbimeve të cilësisë së lartë për interesin publik
- Nxjerrë deklaratat ndërkombëtare mbi çështjet teknike, etike dhe arsimore për profesionin e kontabilitetit
- Anëtarëson 167 Shoqata nga 127 shtete të botës
- Mbledhja e parë e Këshillit – Tetor, 1977 (Gjermani)

ShKÇAK – Anëtare e IFAC

IFAC - FNK

- IFAC është themeluar për forcimin e profesionit të kontabilitetit në mbarë botën në interes të publikut nëpërmjet:
 - Zhvillimit të standardeve ndërkombëtare të cilësisë së lartë dhe mbështetjen e miratimit dhe të përdorimit të tyre;
 - Lehtësimi i bashkëpunimit dhe kooperimit ndërmjet organeve të saj anëtare;
 - Bashkëpunimidhe kooperimi me organizata të tjera ndërkombëtare, dhe
 - Të shërbejë si zëdhënës ndërkombëtar i profesionit të kontabilitetit

IFAC - FNK

- Duke filluar me 63 anëtarë në vitin 1977, anëtarësimi në FNK-së është rritur gjatë 30 viteve të fundit dhe tani përfshijnë 167 anëtarë dhe bashkëpunëtorë në 127 vende dhe juridiksione në mbarë botën me mbi 2,5 milion kontabilistë.

<http://www.ifac.org/History/>

BSNAS

- Për ta përmbushur misionin e vetë, IFAC themelon Komitetin Teknik – BSNAS – Bordin e Standardeve ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë.
- Nxjerr SNA-të
- Përmirësim I shkallës së uniformitetit të praktikave të auditimit dhe shërbimeve të ndërlidhura nëpër gjithë botën.
- SNA-të duhet të zbatohen në auditimin e informacioneve financiare historike.

IAASB - BSNAS

Është një trup i pavarur i cili lëshon SNA-të, Standardet e rishikimit dhe standardet e tjera të shërbimeve të përsigurisë si dhe të kontrollit të cilësisë për tu zbatuar në mënyrë globale në profesionin e auditimit.

Ky është një trup i FNK-së.

Bordi i Mbikqyrjes së Interesit Publik (BMIP) siguron mbikqyrjen e BSNAS, duke siguruar se standardet janë në interes të publikut.

IAASB - BSNAS

IAASB – BSNAS lëshon Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA), Standardet Profesionale të Performancës (SPP) për kryerjen e auditimeve të informacionit financiar.

Zhvillimi dhe statusi i SNA-ve

Standardet e BSNAS përmbajnë parimet themelore dhe procedurat thelbësore bashkë me udhëzimet specifike në formën e materialeve shpjeguese dhe materialeve të tjera, përfshirë këtu shtojcat.

Parimet themelore dhe procedurat thelbësore duhet të kuptohen dhe zbatohen në kontekstin e materialeve shpjeguese dhe materialeve të tjera të cilat japin udhëzime për sa i takon mënyrës së zbatimit të tyre.

Është pra e domosdoshme të mbahet parasysh i gjithë teksti i një standardi në mënyrë që të kuptohen dhe zbatohen parimet themelore dhe procedurat thelbësore që përmbahen në të.

Zhvillimi dhe statusi i SNA-ve

Në rrethana shumë të rralla, auditori mundë të gjykojë të arësyeshme moszbatimin e një SNA-je në mënyrë që të arrihet më me efektivitet objektivi i një auditimi.

Në rastet kur kemi të bëjmë me një situatë të tillë, auditori duhet të jetë i përgatitur për të arësytuar moszbatimin e standardit në fjalë.

SNA-të nuk kundërshtojnë rregulloret vendore:

- a) Për sa kohë që SNA janë në përputhje me to
- b) Nëse janë në kundërshtim, anëtari duhet të zbatojë detyrimet që dalin nga Kushtetuta e IFAC.

SNA-të

- SNA-200 - Objektivi dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë një auditim të pasqyrave financiare
- SNA-210 – Kushtet e angazhimit në auditim
- SNA-220 – Kontrolli i cilësisë për auditimin e informacioneve financiare historike
- SNA-230 – Dokumentimi i auditimit
- SNA-240 – Përgjegjësia e audituesit për të marrë në konsideratë mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare
- SNA-250 – Marrja një konsideratë e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiare
- SNA-260 – Komunikimi i çështjeve të auditimit me personat e ngarkuar për qeverisje

SNA-të

- SNA-300 – Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare
- SNA-315 – Njohja e entitetit, mjedisit të tij dhe vlerësimi i rreziqeve të gabimeve materiale
- SNA-320 – Materialiteti i auditimit
- SNA-330 – Procedurat e audituesit në përgjigje ndaj rreziqeve të vlerësuara
- SNA-402 – Konsiderata auditimi ndaj entiteteve që përdorin organizata për shërbime
- SNA-500 – Evidenca e auditimit
- SNA-501 – Evidenca e auditimit – konsiderata shtesë për zëra specifikë
- SNA-505 – Konfirmimet nga të tretët (palët e treta)

SNA-të

SNA-510 – Angazhimet fillestare – saldot fillestare

SNA-520 – Procedurat analitike

SNA-530 – Mostrimi në auditim dhe mvnyra të tjera të testimit

SNA-540 – Auditimi i vlerësimeve (çmuarjeve) kontabël

SNA-545 – Auditimi i pasurive dhe informacioneve shpjeguese me vlerën e drejtë

SNA-550 – Palët e ndërlidhura

SNA-560 – Ngjarjet e mëvonshme

SNA-570 – Hipoteza e vijimësisë

SNA-580 – Përfaqësimet e menaxhmentit

SNA-të

- SNA-600 – Përdorimi I punës së audituesve tjerë
- SNA-610 – Marrja në konsideratë e punës së auditimit intern
- SNA-620 – Përdorimi I punës së një eksperti
- SNA-700 – Raporti I auditorit të pavarur për një komplet të p.f. për qëllime të përgjithshme
- SNA-701 – Modifikimet në raportin e auditorit të pavarur
- SNA-710 – Të dhënat krahasuese
- SNA-720 – Informacione të tjera në dokumentat që përmbajnë pasqyrat financiare të audituara
- SNA-800 – Raporti I auditorit mbi angazhimet e auditimit për qëllime të veçanta/specifike

INTOSAI

INTOSAI u themelua në vitin 1953 me iniciativën e Emilio Fernandez Camus, atëherë kryetar i SNA të Kubës. Në atë kohë, 34 SNA u takuan në Kongresin e parë INTOSAI në Kubë. Aktualisht INTOSAI ka 190 anëtarë të plotë dhe 4 Anëtarë të asocuar.

INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur dhe a-politike. Ajo është një organizatë jo-qeveritare me status special konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të Kombeve të Bashkuara.

INTOSAI

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) vepron si një organizatë ombrellë për komunitetin e auditimit të jashtëm të qeverisë. Për më shumë se 50 vjet ka siguruar një kuadër të institucionalizuar për Institucionet Supreme të Auditimit për të nxitur zhvillimin dhe transferimin e njohurive, të përmirësojë në gjithë botën auditimet e qeverive dhe rritjen e kapaciteteve profesionale, qëndrimin dhe ndikimin e SNA në vendet e tyre përkatëse.

INTOSAI

Në përputhje me moton e INTOSAI-së, '*Experientia Mutua omnibus prodest*', shkëmbimi i përvojës mes anëtarëve të INTOSAI-t dhe gjetjet dhe njohuritë të cilat rezultojnë, janë një garanci se auditimet e qeverive vazhdimisht përparojnë me zhvillimet e reja.

Kodi i qeverisjes korporative


Qeverisja e korporatës është një sistem sipas të cilit drejtohen dhe kontrollohen kompanitë – korporatat.

Palët e interesuara për kompanin-korporatën janë:


- Drejtorët: përgjegjës për qeverisjen e korporatës
- Aksionerët: që janë të lidhur me drejtorët nëpërmjet p.f.
- Palët e tjera: punonjësit, klientët, furnitorët

Qeverisja korporative-synim i auditimit të jashtëm

Qeverisja korporative: është sistem përmes së cilës kompania është e drejtuar dhe e kontrolluar



SKEMA E QEVERISJES KORPORATIVE



Kodet vullnetare

- Menaxhimi i kompanive
- Çështja kyçe e qeverisjes – Vendosja e prioriteteteve
- Prioriteti më i lartë vendoset mbi interesat e aksionarëve,
- Edhe aksionarët janë të ndryshëm (si kompanitë):
 - Të një familjeje
 - Publiku i përgjithshëm
 - Institucionet përfaqësuese (Fondet)
- Bashkëveprimi i aksionarëve me kompanian është i ndryshëm(TPV)

Parimet e OECD-së

- U publikuan në 1999 dhe u rishikuan në 2004
- Shërbejnë si një referencë për vendet dhe kompanitë (Nëse dëshirojnë)

Avantazhet:

Në raste vullnetare, kodet duhet ta ruajnë fleksibilitetin (të përshtaten)

Disavantazhet:

Në raste vullnetare, kompanit mundë të mos veprojnë në përputhje me kodet, si rezultat-aksionarët vështirë marrin vendime.

Zgjidhja:

Qasja hibride-disa elemente të QK janë të detyrueshme, disa vullnetare.

Kodet e praktikave të mira

Parimet e OBZHE/OECD për qeverisjen e korporatës parashtrojnë të drejtat e aksionarëve, rëndësinë e shënimeve shpjeguese dhe transparencës bashkë me përgjegjësitë e bordit të drejtorëve.

OECD-Parimet e Qeverisjes korporative

- Të drejtat e aksionerëve

Korniza e qeverisjes korporative do të përkrahë të drejtat

- Trajtim i paanshëm i aksionerëve

Korniza e qeverisjes korporative do të sigurojë përkrahje të drejtë për të gjithë aksionerët, duke marrë parasysh

- Aksionerët e vegjël dhe të jashtëm

Të gjithë aksionerët do të kenë mundësi të rivendosin rregullime për ndonjë shkeljeje të drejtave të tyre.

- Roli i aksionerëve

Korniza e Q.K. njeh të drejtat e aksionerëve dhe i inkurajon në kooperim aktiv ndërmjet entitetit dhe aksionerëve në krijimin e pasuris, punës dhe qëndrueshmërisë së shëndoshë financiare.

OECD-Parimet e Qeverisjes korporative

- Shpalosja dhe transparencja

Korniza e Q.K. do të sigurojë në kohë dhe me korrektësi që shpalosja të përdoret në gjithë aspektin material në lidhje me entitetin, marrë për bazë edhe situatën financiare, performancën, pronësinë dhe qeverisjen e entitetit.

- Përgjegjësia e Bordit

Korniza e Q.K. do të sigurojë udhëheqje strategjike të entitetit, mbikëqyrje efektive të menaxhmentit nga bordi, dhe përgjegjësinë e bordit ndaj entitetit dhe aksionerëve të sajë.

Kombinim i Kodit të Q.Korporative

- Bordi
 - Do të takohet rregullisht
 - Balancojë ndërmjet ekzekutive/jo-ekzekutive
 - Disa jo-ekzekutive jë jenë të pavarura
 - Proces nominimi rigoroz/transparent
 - Drejtorat t'i nënshtrohen ri-zgjedhjes
 - Roli i kryetarit dhe CEO të jetë i ndarë
 - Bordi do të themelojë sistem të shëndoshë të KB
 - Komiteti i auditimit do të themelohet
 - Mendojë për nevojën për Auditor të brendshëm

Audituesit

Kodi i kombinuar sugjeron që:

1. Të gjitha kompanitë të kenë një auditim të pavarur vjetor
2. Informacionet duhet të shpjegohen dhe auditohen sipas standardeve të cilësisë së lartë (për rritjen e besueshmërisë dhe krahasueshmërisë)
3. Përfitimi i informacioneve shtesë nga aksionarët që dalin prej këtyre kontrolleve.

Këto informacione përfshijnë shenimet shpjeguese që kanë të bëjnë me:

Shenimet shpjeguese:

- Rezultatet financiare dhe operacionale të kompanisë
- Objektivat e kompanisë
- Pronësinë e aksioneve kryesore dhe të drejtave të votimit
- Anëtarët e bordit, nëpunësit kryesor ekzekutiv, dhe kompensimet e tyre
- Faktorët e parashikueshëm material të rrezikut
- Çështjet materiale që kanë të bëjnë me punonjësit dhe aksionerët e tjerë
- Strukturën dhe politikat e qeverisjes.

Drejtorët

Si përgjegjës për menaxhimin e kompanis, vendosin strategji, buxhetojnë, menaxhojnë resurset njerëzore, ruajnë pasurin, zbatojnë rregullat e qeverisjes së mirë të korporatës. Për t'i realizuar këto, drejtorat krijojnë politikat e kompanisë, duke përfshirë edhe politikat për menaxhimin e rrezikut, dhe dizajnojnë sistemet e kontroleve përkatëse në kompani për t'u siguruar nga përgjegjësitë.

Sistemet, kontrollet dhe monitorimi

Drejtorët janë përgjegjës për:

- Vënien në funksion të sistemeve të kontrollit për shmangjen e rreziqeve
- Themelimin e departamentit të auditimit të brendshëm (vendosin nëse duhet)
- Monitorimin e efektivitetit të sistemeve dhe kontrolleve (përmes auditimit të brendshëm)

Udhëzimet Turnbull (1999)

- Të ketë proces të përcaktuar për efektivitetin e K.B.
- Të rishikohen rregullisht raportet mbi K.B.
- Të mbahen parasysh rreziqet themelore dhe mënyra se si menaxhohen ato
- Të kontrollohet përshtatshmëria e veprimeve të ndërmarra për të larguar dobësitë dhe incidentet
- Të mbahet parasysh përshtatshmëria e monitorimit
- Të bëhet vlerësimi vjetor i rreziqeve dhe i efektivitetit të K.B.
- Të bëhet një deklaratë mbi proceset e sipërpërmendura në raportin vjetor.

Komiteti i auditimit

Është një nën-komitet i BD i cili përmban zakonisht një numër të caktuar drejtorësh jo-ekzekutiv (drejtorë pa funksione ekzekutive në kompani) i ndihmon kompanisë në ruajtjen e objektivitetit për rap.fin. dhe auditimit të p.f.

KA ka mundësi të:

- a) Përmirësojë cilësinë e rap.fin. me rishikim në emër të Bordit
- b) Krijon klimë discipline dhe kontrolli-zvogëlim i mundësive për mashtrime
- c) Mundëson që drejtorët jo-ekzek.të kontribuojnë me gjykimin e pavarur dhe rishikimin e politikave kontabël.

Komiteti i auditimit

- d) Ndhimë drejtorit financiarë
- e) Forcojë pozicionin e auditorit të jashtëm
- f) Ofrojë një kornizë brenda së cilës auditori i jashtëm mundë t'a mbrojë pavarësinë e tij në rastë mosmarrëveshjeje me menaxhmentin
- g) Forcojë pozicionin e funksioneve të auditimit të brendshëm
- h) Rrisë besimin e publikut për sa i takon besueshmërisë dhe objektivitetit të pasqyrave financiare.

Avantazhi kryesor:

Komiteti i drejtorëve jo-ekzekutiv i ofron auditorit një pikë të pavarur reference nëse ndodhë ndonjë mosmarrëveshje.

Efektiviteti i kontrolleve të brendshme

Drejtorët janë përgjegjës për të dizajnuar sisteme efektive të KB.

Kontrollet efektive kontribuojnë në:

- Ruajtjen e pasurive të kompanisë
- Parandalimin dhe gjetjen e gabimeve dhe mashtrimeve
- Ruajtjen e investimeve të aksionarëve
- Biznesi të operojë në mënyrë efektive
- Zvogëlon rreziqet e identifikuara me të cilë përballet biznesi
- Ofron besueshmëri më të madhe të raportimit
- Ofron besueshmëri më të madhe të vepruarit në përputhje me ligjet.

Përgjegjësia e drejtorëve

Përgjegjësia përfundimtare për K.B. i takon Bordit të drejtorave.

- Vlerësimi i rreziqeve me të cilat përballet biznesi (për t'i shmangur)
- Kufizimet e vetvetishme – marëveshjet e fshehta
- Rishikimi i KB në mënyrë të rregullt
- Auditimi i brendshëm
- Rishikim i rregullt i nevojës për AB
- Raportimi i BD mbi rishikimet e KB
- Vlerësimi vjetor i KB duke mbajtur parasysh të gjitha aspektet e rëndësishme të KB.

Përgjegjësitë e auditorit

- Rishikon deklaratat e bëra për k.b. në raportin vjetor për tu siguruar se ato janë të vërteta dhe konform pf.të audituara
- Vlerësoj nëse procesi i kompanis është mbështetur me dokumente të përgatitura prej drejtorëve të cilët reflektojnë këtë proces
- Heton dhe rishikon deklaratat e BD në p.f. dhe dok.mbështetës
- Të kuptoj në nivel të pranueshëm k.b.për shtrirjen e proc.të aud.
- Të komunikojë shpejt dobësit materiale të vërejtura me drejtorët

Pyetje?

